

KOSOVË: RIKTHIMI I LIRISË SË MEDIAVE PAS RËNIES

RAPORT I MISIONIT FAKTMBLEDHES

Korrik 2026

Rreth Platformës së Këshillit të Evropës për Promovimin e Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve

Më 4 dhjetor 2014, Këshilli i Evropës dhe [Organizatat Partnere](#) të platformës nënshkruan një [Memorandum Mirëkuptimi](#). Sot, 16 organizata joqeveritare dhe shoqata ndërkombëtare gazetarësh janë partnerë të Platformës.

Në përputhje me Memorandumin, Platforma u mundëson partnerëve që ta njoftojnë Këshillin e Evropës dhe shtetet anëtare për kërcënime serioze në lidhje me lirinë e mediave. Nga shtetet anëtare pritet të reagojnë ndaj çështjeve dhe t'i informojnë partnerët e Platformës dhe Këshillin e Evropës mbi veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj njoftimeve.

Sipas Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë detyrime pozitive për të siguruar një mjedis të favorshëm për lirinë dhe pluralizmin e mediave.

Platforma gjithashtu vë në pah punën e kryer nga Këshilli i Evropës në fushën e lirisë së mediave, siç janë tekstet (dokumentet) e përgatitura nga Asambleja Parlamentare, standardet e miratuara nga Komiteti i Ministrave, jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe punën e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut.

Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, ajo nuk bie në fushëveprimin e mekanizmit paralajmërues të Platformës, i cili është i kufizuar në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Prandaj, organizatat partnere janë përpjekur t'i dokumentojnë zhvillimet përmes misionëve periodike faktmbledhëse që synojnë mbledhjen e informatave të dorës së parë mbi mjedisin mediatik dhe sigurinë e gazetarëve në Kosovë. Misioni aktual është zhvilluar pas një vizite të mëparshme të organizuar nga partnerët e Platformës në vitin 2022.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Siguria e gazetarëve.....	7
Transmetuesi Publik dhe Komisioni i Pavarur i Mediave.....	10
Transparenca e institucioneve publike/ Fol.....	14
Legjislacioni që lidhet me lirinë e mediave	15
Gazetarët në rezidencë (gazetarët ukrainas)	18
Rekomandimet	19

Hyrje

Më 24-26 mars 2026, partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës për Promovimin e Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve organizuan një mision faktmbledhës në Prishtinë. Ky raport u hartua nga anëtarët e delegacionit dhe pasqyron gjetjet kryesore dhe ofron rekomandimet përkatëse.

Misioni në Kosovë u krye nga organizatat e mëposhtme: Asociacioni i Gazetarëve Evropianë (AEJ), Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Mediave (ECPMF), Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ), Indeksi mbi Censurën, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (IPI), Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa (OBCT), Unioni Evropian i Transmetuesve (EBU) dhe Reporterët pa Kufij (RSF). Misioni u mbështet nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Vizita dy-ditore ishte vazhdimësi e një misioni të ngjashëm për mbledhjen e fakteve në Kosovë të organizuar nga partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës në vitin 2022, gjatë të cilit u evidentuan një sërë gjetjesh. Gjetjet e misionit të mëparshëm mund të lexohen [këtu](#).

Misioni i fundit synonte të vlerësonte situatën për lirinë e mediave, pluralizmin dhe sigurinë e gazetarëve, ndër tema të tjera. Vizita u zhvillua pas monitorimit dhe avokimit nga një numër organizatash pjesëmarrëse, të cilat kishin raportuar zhvillime shqetësuese që kërkonin vëmendje.

Gjatë misionit, delegacioni u takua me kryeministrin Albin Kurti¹ dhe gjithashtu me një gamë të gjerë akterësh profesionistë të mediave, duke përfshirë gazetarë dhe redaktorë kryesorë nga media online, transmetuese dhe investigative, si dhe shoqata mediatike, ekspertë të mediave dhe shoqërinë civile. Në takime të tjera morën pjesë gazetarë dhe anëtarë të menaxhmentit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), përfaqësues të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Një takim i veçantë u mbajt me përfaqësues të ambasadave të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë Këshillin e Evropës (KiE), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Bashkimin Evropian. Më 26 mars u mbajt edhe një konferencë për media në Prishtinë.

Misioni u mbajt gjatë një periudhe të pasigurisë politike në Kosovë, pas zgjedhjeve të përsëritura parlamentare dhe bllokadës politike për zgjedhjen e presidentit të vendit. Pas vizitës në fund të marsit, u zhvilluan zgjedhje të tjera të parakohshme më 29 prill, të cilat u mbajtën në qershor 2026. Në kohën kur është publikuar ky raport, ende nuk është krijuar qeveria e re.

Ky raport dhe rekomandimet e tij u janë dërguar autoriteteve kombëtare në Kosovë dhe janë ndarë me Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian, Kombet e Bashkuara dhe OSBE-në. Delegacioni shpreh falënderime për të gjithë akterët që pranuan të merrnin pjesë në takime gjatë misionit. Delegacioni mbetet i hapur për diskutime të mëtejshme me autoritetet e Kosovës dhe qeverinë e formuar pas korrikut 2026.

¹ Përveç kësaj, pas takimit, delegacioni i dërgoi një listë pyetjesh zyrës së Kryeministrit Albin Kurti para publikimit të raportit. Përgjigjet e tyre janë përfshirë në raport.

Përmbledhje ekzekutive

Delegacioni arrin në përfundimin se, ndonëse Kosova ka një peizazh mediatik pluralist, nivele të ulëta të dhunës fizike ndaj gazetarëve dhe një kornizë legjislativë gjerësisht të harmonizuar me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, liria e mediave në Kosovë ka shënuar qartazi një periudhë të rënies. Miratimi nga Kuvendi i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media (ligjit për media) – i cili më pas u shpall antikushtetues – që do të rriste kontrollin politik mbi KPM, financimi i pamjaftueshëm dhe presionet ndaj Radio Televizionit të Kosovës (RTK), si dhe shtimi i vazhdueshëm i sulmeve verbale dhe denigrimit të gazetarëve nga politikanë të partisë në pushtet, janë faktorët kryesorë që qëndrojnë pas këtij vlerësimi.



Përfaqësues të organizatave për lirinë e mediave takohen me Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, gjatë misionit ndërkombëtar për lirinë e mediave.
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Disa standarde të lirisë së mediave janë cenuar nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Si rezultat, nga një nivel i qëndrueshëm i lirisë së mediave në një vend që aspiro anëtarësimin në Bashkimin Evropian vendi ka kaluar në një periudhë përkeqësimi gjatë tri viteve të fundit, e nxitur kryesisht nga faktorë politikë. Kosova, e renditur në vendin e 84-të nga 180 shtete në Indeksin Botëror të Lirisë së Mediave të RSF-së për vitin 2026, ka shënuar rënie për 28 vende që nga viti 2023.

Këto zhvillime e kanë cenuar trajektoren e mëparshme pozitive të Kosovës për lirinë e shtypit dhe zhvillimin e mediave që nga pavarësia e vendit në vitin 2008. Kjo e ka dëmtuar statusin e saj si një lider rajonal për lirinë e mediave në procesin e anëtarësimit në BE dhe prandaj nevojitet vullnet i vazhdueshëm politik për adresimin e kësaj situatë.

Me lirinë e medias si një shtyllë kyçe të procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE, qeveria e ardhshme duhet të bëjë punë të konsiderueshme për ta rindërtuar besimin në kredencialet e saj demokratike dhe për t'u rikthyer në rrugën e mëparshme të progresit të lirisë së mediave.

Një faktor kryesor që ka ndikuar në konkluzionet e organizatave pjesëmarrëse në mision është përkeqësimi

i klimës për sigurinë e gazetarëve në Kosovë, veçanërisht për shkak të rritjes së nivelit të denigrimit verbal dhe stigmatizimit të profesionistëve të mediave nga politikanë të nivelit të lartë, shpesh nga radhët e partisë në pushtet, gjë që po ka ndikim toksik si në diskursin publik, ashtu edhe në sigurinë e profesionit.

Numri i përgjithshëm i rasteve të dokumentuara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) që përfshijnë denigrimin, diskreditimin dhe ngacmimin online kundër gazetarëve, veçanërisht nga figura të larta politike, është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, duke arritur kulmin në vitin 2025. Megjithatë, gjatë takimeve me zyrtarë qeveritarë, ndikimi i këtyre presioneve online dhe verbale mbi gazetarët nuk u pranua mjaftueshëm. Kjo çështje shqyrtohet në detaje në kapitullin vijues.

Një shqetësim tjetër kyç lidhet me çështjet ende të pazgjidhura sa i përket financimit dhe pavarësisë së transmetuesit publik RTK, si dhe me akuzat për presione politike ndaj transmetuesit. RTK aktualisht po operon në kushte të vështira ekonomike, pa një zgjidhje për çështjen e pronësisë së saj, gjersa mungesa e financimit i pamundëson investimet e nevojshme.

Gjatë një takimi, menaxhmenti i RTK-së me këmbëngulje i hodhi poshtë akuzat për presion ndaj gazetarëve dhe për kërcënime ndaj pavarësisë editoriale. Megjithatë, delegacioni mbetet seriozisht i shqetësuar lidhur me largimin e prezantuesve të edicioneve të lajmeve, ndërprerjen e emisioneve dhe dëshmitë e vazhdueshme të gazetarëve të saj për presione politike.

Një çështje e tretë thelbësore mbetet pavarësia e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Një ligj i kontestuar për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi në qershor të vitit 2024, u shfuqizua pasi u shpall antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në prill të vitit 2025.

Delegacioni vlerëson se ndryshimi legjislativ do të kishte mundësuar kapjen e mundshme politike të rregullatorit të mediave në Kosovë. Gjersa Kryeministri, gjatë një takimi me delegacionin, mbetej me shpresë se mund të hartohej një ligj i përmirësuar dhe u zotua për angazhimin e vet në këtë proces, fakti që gjykata më e lartë e vendit u desh të shfuqizonte një ligj që kërcënonte pavarësinë e KPM-së përbën një zhvillim alarmues, i cili pasqyron presione më të gjera që prekin themelet e sistemit mediatik të Kosovës.

Procesi i fundit për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit si për RTK-në ashtu edhe për KPM-në - i kryer në prill 2026 pas përfundimit të misionit - vetëm sa i ka thelluar shqetësimet e delegacionit. Gjatë këtij procesi, kandidatët për organet drejtuese të të dy institucioneve u përzgjedhën përmes procedurave të përsheptuara dhe jotransparente, të shoqëruara me parregullsi, të cilat binin ndesh me parimet e përzgjedhjes meritore. Në vend të gatishmërisë për të ndryshuar qasjen nga qeveria pas misionit, ky zhvillim ka nxjerrë në pah shqetësimet e delegacionit në lidhje me ndërhyrjen politike në mbikëqyrjen e pavarur si të RTK-së ashtu edhe të KPM-së.

Së fundi, ndonëse Kosova ka një sektor të larmishëm privat të mediave në tregjet e transmetimit dhe të mediave online, misioni arrin në përfundimin se klima e përgjithshme për gazetarinë e pavarur përballet me sfida që burojnë nga ndikimi i interesave politike dhe të biznesit brenda vendit. Mungesa e masave të qarta mbrojtëse ndërmjet strukturave të pronësisë së mediave, grupeve të biznesit dhe redaksive e ndërlikon më tej këtë situatë. Kjo është një çështje afatgjatë që vazhdon të cenojë gazetarinë në interes publik në përgjithësi dhe gazetarinë hulumtuese në veçanti, të dobësojë kushtet për raportim të pavarur dhe të dëmtojë besimin e publikut në media.


Në kapitujt vijues, misioni e shqyrton sigurinë e gazetarëve, shqetësimet në lidhje me transmetuesin publik dhe organin rregullator të mediave, transparencën e institucioneve publike dhe legjislationin që lidhet me lirinë e mediave. Raporti në fund ofron konkluzione dhe rekomandime për qeverinë, me qëllim forcimin e lirisë së mediave dhe mbështetjen e ushtrimit të gazetarisë së lirë dhe të pavarur.

Siguria e gazetarëve

Gazetarët dhe profesionistët e mediave në Kosovë punojnë në një mjedis gjithnjë e më armiqësor. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Rrjeti SafeJournalists i monitorojnë nga afër sulmet kundër gazetarëve dhe mediave.

Edhe pse numri i sulmeve fizike ka rënë pas rritjes së regjistruar në vitin 2023,² fushatat e shpifjes, ngacmimet dhe kërcënimet verbale janë në rritje, shpesh të iniciuara nga politikanë të rangut të lartë, dhe kanë pasojë serioze për reputacionin dhe sigurinë e gazetarëve. Kjo u konfirmua gjatë një takimi me gazetarë që mbulojnë çështjet politike, shumica e të cilëve deklaruan se kanë qenë cak i sulmeve dhe kërcënimeve verbale për shkak të punës së tyre.

Në vitin 2025, AGK regjistroi 69 raste që përfshinin gazetarë, profesionistë të mediave dhe media, me një numër të konsiderueshëm në rastet e denigrimit, diskreditimit dhe ngacmimit online nga figurat publike: 16 raste i atribuohen zyrtarëve publikë, 14 personave publikë dhe 5 zyrtarëve shtetërorë, përfshirë 2 zyrtarë policie.³ Në vitin 2024 u dokumentuan 54 raste, në vitin 2022 33 raste, kurse në vitin 2021 29 raste. Në vitin 2026, deri më tani janë regjistruar 24 raste.⁴ Sulmet kibernetike paraqiten si kërcënime në rritje, me të paktën dy raste të fundit që kanë përfshirë media online, prania e të cilave në rrjetet sociale – që përbëjnë kanalin kryesor për shpërndarjen e përmbajtjes dhe arritjen e audiençave – është ndërprerë.⁵



² Incidentet e regjistruara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në vitin 2023: <https://agk-ks.org/en/case-search/?keywords=&city=&ngakush=&gjinia=&year=2023&lojiimedias=&lojiincidentit=&ppublik=&qjykesor=&pligjor=&search=1>

³ Incidentet e regjistruara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në vitin 2025: <https://agk-ks.org/en/case-search/?keywords=&city=&ngakush=&gjinia=&year=2025&lojiimedias=&lojiincidentit=&ppublik=&qjykesor=&pligjor=&search=1>

⁴ Incidentet e regjistruara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në vitin 2026: <https://agk-ks.org/en/case-search/?keywords=&city=&ngakush=&gjinia=&year=2026&lojiimedias=&lojiincidentit=&ppublik=&qjykesor=&pligjor=&search=1>

⁵ <https://agk-ks.org/rastet/sulme-ndaj-mediave-dhe-organizatave-mediave-vox-kosova-prishtine-01.04.2026/>
<https://agk-ks.org/rastet/sulme-ndaj-mediave-dhe-organizatave-mediave-reporteri-prishtine-01.03.2026/>

Kërcënimet digjitale ndaj gazetarëve janë veçanërisht të përhapura. Që nga viti 2020, me kalimin e të gjitha mediave në internet, rastet e ngacmimit digjital, kërcënimeve me vdekje, frikësimit dhe fushatave të shpifjes janë shumëfishuar. Siç u konfirmua gjatë një takimi me përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, kërcënimet online përfaqësojnë rastet më sfiduese për t'u trajtuar. Ekzistenca e një njësie të dedikuar për krimin kibernetik brenda policisë, në disa raste, ka bërë të mundur identifikimin e autorëve. Gratë gazetare janë një objektiv veçanërisht i shpeshtë: ato përballen me rreziqe që lidhen me diskriminimin me bazë gjinore, duke përfshirë ngacmimin brenda redaksive, komentet seksiste dhe frikën nga hakmarrja kur flasin hapur.⁶

Presioni politik dhe fushatat e shpifjes mbeten ndër kërcënimet kryesore ndaj gazetarisë së lirë dhe të pavarur. Informatat e mbledhura gjatë misionit të marsit 2026 dhe të dhënat e monitorimit tregojnë se politikanët dhe anëtarët e partisë në pushtet Vetëvendosje janë ndër autorët kryesorë të kërcënimeve verbale dhe frikësimit. Një shembull i spikatur dhe veçanërisht alarmues është vendimi shumë i kritikuar i partisë në pushtet VV për të bojkotuar televizionet kombëtare T7, TV Dukagjini dhe Klan Kosova gjatë zgjedhjeve në fillim të vitit 2025. Në vitin 2026, VV hoqi bojkotin dhe i lejoi anëtarët e vet të shfaqeshin në emisione të ndryshme televizive.⁷ Kjo klimë është ndikuar edhe nga deklaratat e Kryeministrit, retorika e të cilit nganjëherë është përshkruar si delegitimim i gazetarëve dhe portretizim i tyre si persona që veprojnë kundër interesave të Kosovës. Në vitin 2025, kryeministri Kurti i bëri thirrje prokurorisë të hetonte stacionet televizive pasi ato paraqitën rezultatet e exit poll-eve me një marzhë të madhe gabimi.⁸ Në një rast tjetër, kur një gazetar i bëri një pyetje, ai u përgjigj duke thënë: *"Thoni pronarëve të medias suaj t'i kthejnë milionat në buxhetin publik"* (ai po i referohej një çështjeje biznesi që përfshinte pronarin e medias, jo vetë gazetaren apo punën e saj në një çështje me interes publik).⁹ Në një rast tjetër, kryeministri Kurti u ofroi gazetarëve trajnime pasi i fajësoi për rënien në Indeks Botëror të Lirisë së Mediave të RSF-së.¹⁰ Në një rast tjetër, ai deklaroi se mediat online janë pjesë e një "Trekëndëshi të Bermudës" që synon ta fundosë Kosovën.¹¹

Situata e mediave në gjuhën serbe dhe mediave të tjera të komuniteteve jo-shumicë është veçanërisht komplekse, pasi këto media përballen me sfida në shumë fronte, duke përfshirë presionin e lidhur me akterët e jashtëm dhe vështirësitë në qasje në informata publike në gjuhën e tyre. Mediat e pavarura në gjuhën serbe raportuan se i nënshtrohen presionit si nga Prishtina ashtu edhe nga Beogradi, duke përfshirë ekspozimin ndaj asaj që e karakterizuan si propagandë dhe narrativave konkurruese nga të dyja drejtimet. Retorika e përsëritur që i paraqet gazetarët si "armi" të shtetit në mënyrë sistematike e cenon besueshmërinë si të mediave ashtu edhe të profesionistëve individualë.

Një burim tjetër shqetësimi është sjellja e ekipit të mbrojtjes së afërt të Kryeministrit, që në disa raste i ka shtyrë me forcë gazetarët, duke penguar qasjen e tyre në informacion dhe aftësinë e tyre për të bërë punën e tyre. Në disa raste, gazetarët janë ankuar se është përdorur forcë e panevojshme për t'i bllokuar dhe për t'ua pamundësuar gazetarëve bërjen e pyetjeve.¹²

Gjatë një takimi me delegacionin, Kryeministri minimizoi shqetësimet në lidhje me sigurinë e gazetarëve dhe nuk e pranoi seriozitetin e situatës. Delegacioni i bëri thirrje Kryeministrit dhe partisë së tij që të

6 Raport: Siguria e Grave Gazetare në Kosovë 2024 Autore Getoarë Mulliqi Artiola Babuni, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës/SafeJournalist Net, <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2026/01/woman-KOS-ENG-2025.pdf>

7 Letër e hapur drejtuar z. Albin Kurti, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Kryeministër i Kosovës, <https://www.ecpmf.eu/open-letter-to-mr-albin-kurti-president-of-vete-vendosje-movement-and-prime-minister-of-kosovo/>

8 <https://agk-ks.org/rastet/kercenime-te-tjera-ndaj-gazetareve-prishtine-13.10.2025/>

9 <https://agk-ks.org/rastet/kercenime-te-tjera-ndaj-gazetareve-arbereshe-uka-prishtine-06.08.2025/>

10 <https://agk-ks.org/rastet/sulme-te-tjera-ndaj-gazetareve-dhe-medie-prishtine-10.05.2025-1/>

11 <https://agk-ks.org/rastet/sulm-ndaj-medie-dhe-organizatave-mediale-prishtine-9.2.2025/>

12 <https://agk-ks.org/rastet/pengim-ne-kryerjen-e-detyres-ndaj-gazetares-blerta-dallosi-berisha-prishtine-28.12.2023/>
<https://agk-ks.org/rastet/pengim-ne-ushttrimin-e-detyres-prishtine-12.05.2023/>

përmbahen nga përdorimi i gjuhës përçmuese kundër gazetarëve dhe profesionistëve të mediave, duke i nxitur që të japin një shembull pozitiv për shoqërinë në tërësi. Kryeministri nuk bëri asnjë zotim konkret, duke i përforcuar kështu shqetësimet se marrëdhëniet midis institucioneve qeveritare dhe medias janë bërë gjithnjë e më të tensionuara. Në pyetjet pasuese me shkrim të dërguara në zyrën e Kryeministrit Kurti, zyra u përgjigj: "Ai nuk mbështet ose toleron abuzimin verbal ndaj gazetarëve, pavarësisht se prej nga vjen ky abuzim. Standardet e diskursit publik respektues që ai i mbështet publikisht pasqyrohen në sjelljen e tij dhe ai kurrë nuk ka përdorur gjuhë fyese ndaj gazetarëve." Zyra e Kryeministrit iu referua më tej numrit të votuesve të VV-së dhe tha se Kryeministri nuk mund të mbahet përgjegjës për deklaratat e bëra nga secili mbështetës individual.



Delegacioni u takua me përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Në një frymë pozitive, takimet me anëtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës konfirmuan qasjen konstruktive të autoriteteve gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit në trajtimin e rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve. Gazetarët dhe redaktorët e takuar gjatë misionit u shprehën të kënaqur me cilësinë e përgjigjeve të sistemit gjyqësor, me rastet që u trajtuan relativisht shpejt, veçanërisht nga gjykatat.

Një tjetër zhvillim inkurajues është Strategjia 2026–2028 e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për përmirësimin e qasjes në drejtësi, e cila i jep përparësi rasteve që përfshijnë sigurinë, shpifjen dhe Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Efektet e saj pozitive janë tashmë të dukshme në gjykimin e shpejtë të rasteve, dhe strategjia është mirëpritur nga Koalicioni Kundër SLAPP-ve në Evropë (CASE) si një praktikë e mirë që mund të shërbejë si model për vendet e tjera evropiane. Akterët mediatikë e vlerësuan procesin e hapur dhe transparent nga KGJK-ja që çoi në miratimin e kësaj strategjie. Një tjetër komponent që u prit mirë janë programet e trajnimit të dedikuara për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, të ofruara nga Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me PROFREX,¹³ një projekt i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian i cili ofron trajnime të rregullta për profesionistët ligjorë mbi çështjet e lirisë së mediave, të tilla si shpifja, siguria e gazetarëve, SLAPP-et etj. Praktika të tilla të mira vënë në pah pse sistemi i drejtësisë është institucioni të cilit komuniteti i gazetarëve i beson më shumë.

13 Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mediave (PRO-FREX), <https://www.coe.int/en/web/pristina/protecting-freedom-of-expression-and-of-the-media-pro-frex-k>

Në përgjithësi, gazetarët në Kosovë përballen me kërcënime të përsëritura për sigurinë dhe lirinë e tyre profesionale, si online ashtu edhe offline. Kërcënimet verbale, ngacmimet, fushatat e shpifjes, retorika përçarëse dhe presioni politik janë të përhapura, duke prekur gazetarët hulumtues dhe veçanërisht gratë gazetare. Roli pozitiv i luajtur nga institucionet gjyqësore dhe zbatimi i ligjit ofron një shkëndijë shprese në një kontekst më të gjerë të rënies së sigurisë së mediave në Kosovë.

Transmetuesi Publik dhe Komisioni i Pavarur i Mediave

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) dhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) përfaqësojnë dy shtyllat qendrore të infrastrukturës së mediale të Kosovës. Të dy institucionet janë vënë nën presion të vazhdueshëm vitet e fundit, duke ngritur shqetësime serioze në lidhje me pavarësinë, qeverisjen dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë. Gjetjet e delegacionit në të dy fushat pasqyrojnë një model ndërhyrjeje politike dhe neglizhence strukturore që rrezikon të dëmtojë në thelb themelet e sistemit mediatik të Kosovës. Shqetësimet e shprehura nga një sërë akterësh në lidhje me ndikimin politik të raportuar, sfidat e qeverisjes dhe dobësitë strukturore, nëse lihen pa u adresuar, mund të cenojnë rëndë themelet e sistemit mediatik të Kosovës.

Transmetuesi publik

Sipas përfaqësuesve të RTK-së dhe akterëve tjerë të intervistuar nga delegacioni, situata financiare e RTK-së është përkeqësuar në një nivel kritik dhe mbetet shqetësuese. Sipas Ligjit për RTK-në, transmetuesi ka të drejtë për 0.7% të të ardhurave vjetore të buxhetit të shtetit, një shifër që arrin në afërsisht 20 milionë euro në vit.¹⁴ Megjithatë, në praktikë, parlamenti miratoi vetëm 8.96 milionë euro për RTK-në në vitin 2025, që përfaqëson më pak se gjysmën e paraparë me ligj. Për shkak të jostabilitetit politik të shënuar nga një sërë zgjedhjesh parlamentare brenda një kohe të shkurtër dhe një numri vendimesh gjyqësore që e detyrojnë RTK-në të paguajë kompensime të ndryshme, pagat e gazetarëve janë vonuar të paktën tre herë në periudhën e fundit, duke nxitur protesta te punonjësit e RTK-së për të kërkuar pagat e tyre.

Në përgjigjen e vet ndaj shqetësimeve të delegacionit, zyra e Kryeministrit deklaroi: “Ne e kemi trajtuar këtë çështje dhe kemi sqaruar se ky detyrim ligjor ka skaduar, duke e bërë çdo referencë ndaj Ligjit për RTK-në në lidhje me buxhetin të pasaktë. Qeveria është e angazhuar të investojë në transmetuesin publik dhe do të hartojë kornizën e nevojshme ligjore për të mbështetur reformën e tij. Vlen të përmendet se 8.9 milionë euro në vit janë një buxhet i konsiderueshëm për një organizatë mediatike. Përshkrimi i kësaj shume si 'vetëm' 8.9 milionë euro i bën padrejtësi mediave private që operojnë me buxhete shtatë deri në nëntë herë më të vogla. Fakti që ky financim ka shkuar kryesisht për paga ngre pyetje legjitime që bien në përgjegjësinë e RTK-së për t'iu përgjigjur, jo të qeverisë.” Delegacioni faktmbledhës megjithatë i qëndron pohimit se ligji aktual për RTK-në është ende i zbatueshëm në lidhje me buxhetin derisa parlamenti ta ndryshojë atë.

Delegacioni vëren interpretime të ndryshme në lidhje me zbatueshmërinë e Ligjit aktual për RTK-në në ndarjet buxhetore. Delegacioni e kupton që ligji mbetet në fuqi nëse nuk ndryshohet nga Parlamenti. Financimi i qëndrueshëm, i përshtatshëm dhe i parashikueshëm është një kusht themelor për një transmetues të pavarur të shërbimit publik. Pavarësisht interpretimeve të ndryshme të kornizës ligjore aktuale, pasiguria e zgjatur në lidhje me marrëveshjet e financimit mund të ndikojë negativisht në planifikimin strategjik, pavarësinë editoriale dhe aftësinë e RTK-së për të përmbushur detyrën e vet të shërbimit publik.

14 Ligji për RTK-në Nr. 04/L-046, neni 21.4, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2812>

Për më shumë se një vit, RTK-ja veproi në një krizë qeverisjeje nën kufizime të konsiderueshme qeverisjeje, duke përfshirë mungesën e qasjes në buxhetin e vet të miratuar pa një bord të plotë të konstituuar dhe pa një drejtor të përgjithshëm të emëruar ligjrisht. Punonjësit nuk morën paga dhe mbajtën protesta të përsëritura.¹⁵ Unioni Evropian i Transmetuesve (EBU), së bashku me gjashtëmbëdhjetë organizata partnere, përfshirë organizatat e përfaqësuara në delegacion, i drejtuan një letër të hapur kryeministrit në nëntor 2025, duke kërkuar lirim të menjëhershëm të fondeve dhe rikthimin e strukturave qeverisëse të RTK-së. Në një përgjigje të datës 13 nëntor 2025, Kryeministri pranoi rolin thelbësor të RTK-së, por pohoi se qeveria nuk mund të vepronte jashtë kompetencës së saj ligjore ndërsa komisionet parlamentare mbetën jofunksionale. Dy javë pas përgjigjes, qeveria e Kryeministrit Kurti miratoi një buxhet për RTK-në për t'i mbuluar pagat.¹⁶ Megjithatë, modeli i dështimit kronik për të krijuar financim të qëndrueshëm, i përkeqësuar nga një bllokadë e stërzgatur politike në Kuvend, e ka lënë transmetuesin publik në një gjendje pasigurie të vazhdueshme. Delegacioni vëren se pasiguria e stërzgatur në lidhje me qeverisjen dhe financimin ka krijuar sfida për stabilitetin afatgjatë dhe planifikimin operativ të transmetuesit.



Delegacioni për lirinë e mediave takohet me gazetarë dhe redaktorë nga Kosova gjatë misionit ndërkombëtar për lirinë e mediave.
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Një nga çështjet më shqetësuese në lidhje me transmetuesin publik është presioni politik me të cilin përballet transmetuesi, siç është theksuar nga një numër gazetarësh, redaktorësh dhe organizatash mediatike të takuara nga delegacioni në lidhje me pavarësinë editoriale. Disa gazetarë dhe redaktorë i treguan delegacionit faktmbledhës për procedurat disiplinore kundër tyre për refuzimin e përgatitjes së raporteve televizive në kundërshtim me standardet etike, si dhe për anulimin e emisioneve të tyre. Për më tepër, vlen të përmendet se drejtori aktual televiziv i transmetuesit është Rilind Gërvalla, një ish-anëtar dhe donator financiar i partisë në pushtet VV.¹⁷ Gazetarët dhe redaktorët i kushtuan vëmendje këtij fakti në kontekstin e diskutimeve më të gjera lidhur me pavarësinë. Menaxhmenti i RTK-së theksoi se emërimet u bënë në përputhje me procedurat në fuqi.

¹⁵ AGK mbështet protestat e punonjësve të RTK-së, <https://www.agk-ks.org/lajmet/agk-ja-perkrah-protesten-e-tri-sindikave-te-rtk-se-pas-voneses-se-pagave/>

¹⁶ Qeveria ndan buxhetin për RTK-në: Kurti thotë se mjetet vijnë nga kursimet - <https://www.dukagjini.com/qeveria-ndan-buxhetin-per-pagat-e-rtk-se-kurti-mjetet-vijne-nga-kursimet/>

¹⁷ Financuesi i Vetëvendosjes emërohet drejtor i kanaleve në gjuhën shqipe RTK1, RTK3 dhe RTK4. <https://kallxo.com/lajm/financuesi-i-vetevendosjes-zgjidh-drejtor-i-kanalit-ne-gjuhen-shqipe-rtk1-3-dhe-4/>

AGK ka dokumentuar disa raste presioni mbi stafin e RTK-së. Në gusht 2025, gjashtë redaktorë të RTK-së u larguan nga programet e tyre televizive, gjë që AGK e konsideroi një akt censure dhe hakmarrjeje, pasi redaktorët kishin kritikuar qeverinë dhe parlamentin për vonesa në pagesat e pagave.¹⁸ Menaxhmenti i RTK-së e kundërshtoi këtë karakterizim. Avokati i Popullit ka hapur një hetim për censurë dhe presion politik ndaj gazetarëve të RTK-së dhe në kohën e publikimit të këtij raporti, hetimi ende nuk i ka publikuar gjetjet.¹⁹ Për më tepër, pas një interviste televizive, një anëtare e partisë në pushtet VV, Fitore Pacolli, e cila aktualisht shërben si Ministre në detyrë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e akuzoi publikisht gazetaren Blerta Foniqi në korrik 2025 se bënte pyetje “të porositura nga jashtë” dhe pretendoi se gjatë intervistës ajo ishte me mision të drejtuar nga akterë të jashtëm.²⁰ Një muaj më vonë, programi televiziv i drejtuar nga Foniqi dhe redaktorë të tjerë u suspendua dhe u hoq nga transmetimi.²¹ Menaxhmenti i RTK-së i paraqiti delegacionit një version tjetër në lidhje me arsyet e këtij vendimi. Në shkurt të vitit 2026, kontratat e dy gazetarëve, Edina Avdiu dhe Hana Martetit, nuk u vazhduan.²² Avdiu kishte refuzuar të lexonte një lajm të shkruar paraprakisht që i ishte dhënë nga redaktori/ja, i cili lavdëronte Kryetarin e sapozgjedhur të Parlamentit, i cili në atë kohë vinte nga partia në pushtet.²³ Ajo e konsideroi tekstin jo të përshtatshëm nga ana profesionale.

Delegacioni i ngriti këto shqetësime gjatë një takimi me menaxhmentin e RTK-së, gjatë të cilit përfaqësuesit e RTK-së hodhën poshtë me këmbëngulje pretendimet për presion mbi gazetarët dhe kërcënime ndaj pavarësisë editoriale. Menaxhmenti i RTK-së hodhi poshtë pretendimet se prezantuesit ishin larguar për arsye disiplinore ose politike, duke deklaruar se vendimet mbi rolet e prezantimit dhe moderimit bien nën përgjegjësinë e menaxhmentit editorial dhe se gazetarët në fjalë kanë ruajtur kontratat, kompensimet dhe pozitat e tyre zyrtare.

Shqetësimet e delegacionit nuk u shuan nga këto deklaramë nga menaxhmenti i RTK-së. Gjersa menaxhmenti i RTK-së dha shpjegime në lidhje me këto raste dhe hodhi poshtë akuzat për ndërhyrje politike, shqetësimet vazhdojnë të shprehen nga gazetarët, organizatat mediatike dhe akterët tjerë. Delegacioni vëren shqetësimet e vazhdueshme të ngritura nga bashkëbiseduesit në lidhje me ndryshimet e programeve dhe trajtimin e mosmarrëveshjeve të brendshme, dhe shpreh shqetësime serioze në lidhje me largimin e prezantuesve të lajmeve dhe mbylljen e programeve, si dhe shqetësimet e vazhdueshme për presion politik brenda transmetuesit. Delegacioni inkurajon procedura transparente dhe mekanizma efektivë për ta mbrojtur pavarësinë editoriale dhe për të adresuar shqetësime të tilla. Strukturat e forta qeverisëse, procedurat transparente të emërimit dhe masat që mbrojnë autonominë editoriale janë thelbësore për ruajtjen e besimit publik në RTK, dhe se çdo reformë e ardhshme duhet të udhëhiqet nga parimet evropiane në lidhje me qeverisjen dhe pavarësinë e mediave të shërbimit publik.

Për më tepër, delegacioni vëren gjithashtu rastin në vazhdim që lidhet me publikimin e një raporti nga RTK me bazë në një medie nga Bosnja dhe Hercegovina pa verifikim paraprak, i cili pretendonte se dy media online, Nacionale dhe Periskopi, ishin financuar nga Serbia. Raportimi shkaktoi një reagim të madh nga partia në pushtet dhe mbështetësit e saj, të cilët i bënë thirrje prokurorisë t’i hetojë të dy mediat. Vendimet pasuese nga KPM-ja, Këshilli i Mediave të Shkruara dhe një hetim i brendshëm i RTK-së zbuluan se RTK nuk e kishte verifikuar informacionin dhe arriti në përfundimin se raportimi shkelte standardet etike profesionale. RTK më vonë publikoi një reagim bazuar në vendimin e KPM-së. Media online Nacionale ka ngritur një padi për shpifje kundër RTK-së, me seancën e parë dëgjimore të mbajtur më 5 maj 2026. Gjykimi i rastit është ende në vazhdim e sipër.²⁴

18 <https://www.agk-ks.org/rastet/pengim-ne-kryerje-te-detyres-ndaj-gjashte-gazetareve-te-rtk-se-prishtine-23.08.2025/>

19 <https://oik-rks.org/2025/09/05/avokati-i-popullit-takoi-redaktoret-e-rtk-se/>

20 <https://agk-ks.org/rastet/sulme-te-tjera-ndaj-gazetares-blerta-foniqi-kabashi-prishtine-28.07.2025/>

21 <https://agk-ks.org/rastet/pengim-ne-kryerje-te-detyres-ndaj-gjashte-gazetareve-te-rtk-se-prishtine-23.08.2025/>

22 <https://agk-ks.org/rastet/sulme-te-tjera-ndaj-gazetareve-hana-marteti-dhe-edina-avdiu-prishtine-15.02.2025/>

23 “I përgatitur në zyrat e partisë në pushtet” — ky është teksti për Dimal Bashën që gazetarja e RTK-së tha se refuzoi ta lexonte, <https://www.gazetaexpress.com/i-pergati-tur-ne-zyrat-e-partise-ne-pushtet-ky-eshte-teksti-per-dimal-bashen-qe-gazetarja-e-rtk-tha-se-ska-pranuar-ta-lexoje/>

24 Padi në lidhje me artikullin ‘Slobodna Bosna’: Përfaqësuesi i ekipit kombëtar pretendon se RTK publikoi lajme të rreme, ndërsa e paditura argumenton se nuk ishte burimi i informacionit. <https://betimiperdrejtesi.com/padia-per-artikullin-e-slobodna-bosna-perfaqesuesi-i-nacionales-thote-se-rtk-ja-publikoi-lajm-te-rreme-e-paditura-tha-se-sja-ne-autore-te-informacionit/>

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2025 përmendi "kufizimet në buxhet, pronësi dhe burime njerëzore, mosmarrëveshjet e brendshme dhe paqëndrueshmërinë e lidhshimit" të RTK-së dhe paralajmëroi se pa veprime legjislative për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe emërimet në lidhshimit, RTK mbetet "e cenueshme nga presioni politik dhe pasiguria financiare". Ligji për RTK-në nuk është ndryshuar që nga viti 2012, pavarësisht rekomandimeve të përsëritura të BE-së për ta bërë këtë.

Kuvendi i Kosovës zgjodhi bordin e ri të RTK-së më 24 prill 2026. Asociacioni i Gazetarëve, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Lëvizja "Fol"²⁵ që monitoruan procesin e përzgjedhjes (si të anëtarëve të bordit të RTK-së ashtu edhe të anëtarëve të KPM-së), e denoncuan atë si të kompromentuar,²⁶ kritikuan procesin dhe shprehën shqetësime në lidhje me integritetin e tij, duke i kërkuar Parlamentit të mos vazhonte me votimin për anëtarët dhe shprehën zhgënjimin e tyre pas zgjedhjes së tyre.²⁷ Kryetarja e komisionit parlamentar përgjegjës për procesin deklaroi se ai u zhvillua në një mënyrë transparente dhe të bazuar në meritë.

Autoriteti i mediave

Shqetësimet e delegacionit në lidhje me pavarësinë e KPM-së përqendrohen në dy zhvillime të dallueshme, por të ndërlidhura: ligji jokushtetues për mediat (Ligji për KPM-në) i miratuar nga parlamenti në vitin 2024 dhe procesi i kompromentuar i emërimit për anëtarët e KPM-së që ndodhi pasi misionit.

Në dhjetor 2024, parlamenti miratoi Ligjin nr. 08/L-289 për KPM-në, duke shpërfillur kryesisht një opinion ligjor nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, i cili kishte ngritur shqetësime në lidhje me qartësinë ligjore, proporcionalitetin dhe devijimet nga legjislacioni i BE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.²⁸ Ligji u miratua pak para pushimeve të fundvitit, me një diskutim minimal, dhe menjëherë nxiti kritika nga Zyra e BE-së në Prishtinë dhe disa ambasada të shteteve anëtare të BE-së. Në prill 2025, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi ligjin në tërësi pasi vendosi që Neni 15 (nënpagrafët 1.2 dhe 1.3) mbi zgjedhjen e anëtarëve të KPM-së dhe Neni 18 (nënpagrafët 3.4 dhe 3.5) mbi shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve nuk ishin në përputhje me Nenin 141 të Kushtetutës, i cili sanksionon pavarësinë e KPM-së, dhe me Nenin 7 mbi vlerat kushtetuese.

Vendimi u reflektua me përmirësimin e performancës së Kosovës në Indeksin Botëror të Lirisë së Mediave të RSF-së për vitin 2026, ku rritja e treguesit ligjor iu atribua pjesërisht vendimit dhe kapacitetit të përmirësuar të gjyqësorit për të mbrojtur lirinë e mediave.²⁹ Gjatë misionit të marsit 2026 në Prishtinë, Kryeministri Kurti u zotua të hartonte një ligj të rishikuar për KPM-në në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në një takim pasues midis dy përfaqësuesve të delegacionit dhe anëtarëve të stafit nga Zyra e Kryeministrit, ata u zotuan të përfshijnë shoqërinë civile dhe ekspertë të pavarur në procesin e hartimit të ligjit për KPM-në. Në atë kohë, delegacioni e mirëpriti këtë zotim.

Megjithatë, procesi pasues për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të bordit të KPM-së, i kryer në prill 2026 pas përfundimit të misionit, i thelloi shqetësimet e delegacionit në vend që t'i shuante ato. Kandidatët u përzgjedhën përmes procedurave të përsheptuara dhe jotransparente, të shoqëruara me parregullsi, duke minuar parimin e përzgjedhjes së bazuar në meritë. Ky zhvillim, që vjen menjëherë pas misionit dhe zotimeve të deklaruara të Kryeministrit, sugjeron që qëllimet për të respektuar pavarësinë institucionale nuk janë

25 Lëvizja FOL është një organizatë joqeveritare me seli në Kosovë që monitoron punën e RTK-së dhe KPM-së, si dhe punën e Komisionit Parlamentar për Media.

26 Anëtarët e bordeve të RTK-së dhe KPM-së përzgjedhen përmes proceseve të kompromentuara, <https://kli-ks.org/procesi-i-perzgjedhjes-se-anetareve-te-bor-dit-te-rtk-se-eshte-i-komprometuar/>

27 Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të RTK-së është kompromentuar. <https://kli-ks.org/anetaret-e-bordeve-te-rtk-se-dhe-kpm-se-zgjidhen-ne-procese-te-komprometuar/>

28 Këshilli i Evropës ofron mbështetje ligjore për projektligjin e Kosovës* për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), <https://rm.coe.int/legal-opinion-on-the-draft-law-on-the-independent-media-commission-of-/1680afd33b>


29 Kosova, profili i vendit 2026, Reporterët pa Kufij, <https://rsf.org/en/country-kosovo>; Szalai në Pressing: Shfuqizimi i ligjit për KPM që cenonte pavarësinë e mediave ndikoi në rangimin e Kosovës, s'ka arsye për festë, 30 Prill 2026, <https://www.gazetaexpress.com/szalai-ne-pressing-shfuqizimi-ligjit-per-kpm-qe-cenonte-pavaresine-e-mediave-ndi-koi-ne-rangimin-e-kosoves-ska-arsye-per-feste/>

përkthyer në praktikë. Në vend që të përfaqësojnë një ndryshim të drejtimit, emërimet e prillit 2026 duhet të shihen si një vazhdim i së njëjtës qasje që e shtyu Gjykatën Kushtetuese të ndërhynte herën e parë.

Transparenca e institucioneve publike/ Qasja në dokumente publike

Transparenca nga ana e autoriteteve politike dhe institucioneve publike vazhdon të mbetet shqetësim në Kosovë. Çështje të ngjashme ishin identifikuar edhe gjatë misionit të mëparshëm të mbledhjes së fakteve në vitin 2022, ku misioni kishte hasur në shqetësim në rritje për përkeqësimin e situatës së transparencës dhe qasjes në informata nën qeverinë aktuale.³⁰ Katër vjet më vonë, gazetarët e informuan delegacionin se nuk ka pasur përmirësim në aspektin e transparencës ose qasjes në informata.

Siç u theksua në komunikatën e misionit në mars 2026, mungesa e transparencës së autoriteteve publike vazhdon të cenojë gazetarinë mbikëqyrëse dhe atë hulumtuese, duke dobësuar klimën për raportim të pavarur dhe duke ulur besimin e publikut në media.



Gazetarët e intervistuar kritikuan autoritetet politike për mungesën e bashkëpunimit dhe mungesën e mundësive për komunikim me zyrtarët. Ata gjithashtu vunë në dukje pamundësinë për t'i pyetur ministrat dhe Kryeministrin rregullisht në konferenca për shtyp dhe mungesën e konferencave të rregullta për shtyp nga Kryeministri. Redaktorët vunë në dukje gjatë takimit me delegacionin se Kryeministri jep relativisht pak intervista televizive dhe se ai, sipas tyre, në përgjithësi del në mediat ku pyetjet janë më pak kritike.

Sipas raportit të fundit vjetor (2026) nga Agjencia e Kosovës për Informim dhe Privatësi (AIP), gjatë

³⁰ Presioni politik mbi gazetarët rrezikon të cenojë progresin e lirisë së mediave në Kosovë, 2022, <https://www.ecpmf.eu/political-pressure-on-journalists-risks-undermining-media-freedom-progress-in-kosovo/>

periudhës 2021–2025, agjencia regjistroi një rritje në numrin e ankesave të paraqitura në lidhje me të drejtën e qasjen në dokumente publike (e drejta për informim). Në vitin 2021, u morën gjithsej 139 ankesa, duke përfaqësuar numrin më të ulët të ankesave gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2022, numri i ankesave u rrit në 421, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar. Ky trend i rritjes vazhdoi në vitin 2023, me 552 ankesa të regjistruara, ndërsa në vitin 2024 numri arriti në 747 ankesa. Krahasuar me vitet e mëparshme, numri më i lartë i ankesave u regjistrua në vitin 2025, me një total prej 927 ankesash, duke përfaqësuar rritjen më të madhe vjetore që nga viti 2021.³¹

Në një përgjigje me shkrim, zyra e Kryeministrit Kurti ka deklaruar: “Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar ndaj transparencës, llogaridhënies dhe qasjes së hapur në informata si parime thelbësore demokratike. Konferencat e rregullta për shtyp pas mbledhjeve të Qeverisë janë një praktikë e zakonshme dhe kanë vazhduar edhe në mandatin aktual. Përveç kësaj, Kryeministri ka mbajtur konferenca të mëtejshme për shtyp, si individualisht ashtu edhe së bashku me ministrat, ku gazetarët kanë pasur mundësinë të bënë pyetje drejtpërdrejt. Vetëm në 15 javët e para të mandatit, ministrat morën pjesë në më shumë se 20 intervista dhe debate televizive. Ata gjithashtu kanë mbajtur konferenca për media brenda ministrive të tyre përkatëse, duke ofruar mundësi shtesë për shqyrtim publik dhe angazhim me mediat.”

Si përjashtim, delegacioni mirëpret qasjen transparente të përdorur nga sistemi gjyqësor në lidhje me rastet që lidhen me gazetarët dhe mediat. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndan statistika të rregullta me AGK-në dhe OJQ-të e tjera në lidhje me numrin e vendimeve gjyqësore, gjë që lejon që trendet të hartohen, analizohen dhe kuptohen gjatë viteve. Për më tepër, të gjitha oraret e seancave gjyqësore që lidhen me rastet e gazetarëve bëhen publike paraprakisht, dhe seancat janë të hapura dhe monitorohen rregullisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët. Gjyqtarët marrin pjesë rregullisht në ngjarje me shoqërinë civile mbi temat e lirisë së mediave dhe angazhohen në dialog të vazhdueshëm me shoqërinë civile. Të gjitha vendimet e gjykatës publikohen në internet dhe janë lehtësisht të qasshme për publikun. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen në mënyrë efektive.

Legjislacioni që lidhet me lirinë e mediave

Gjatë misionit të mbledhjes së fakteve, delegacioni u takua me një numër akterësh për ta analizuar statusin dhe ndikimin e legjislacionit, dhe propozoi reformë ligjore që do të ndikonte në lirinë e mediave në tërë vendin. Kjo përfshinte ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), Ligjin për Transmetuesin Publik, ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, si dhe propozimin joformal të anëtarëve të partisë në pushtet për ri-kategorizimin e shpifjes si vepër penale. Përveç kësaj, delegacioni shqyrtoi statusin e transpozimit të direktivave dhe rregulloreve përkatëse të BE-së, siç janë Akti i Shërbimeve Digjitale (DSA), Direktiva e Bashkimit Evropian Kundër SLAPP-eve dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës Kundër SLAPP-eve dhe Akti Evropian i Lirisë së Mediave (EMFA).

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave

Në vitin 2023, Qeveria e Kosovës miratoi një projektligj për KPM-në, të njohur si ligji për mediat, i cili është një nga ligjet kryesore për mediat në Kosovë. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile reagueshan duke i bërë thirrje qeverisë ta tërheqë projektligjin, duke e konsideruar atë

31 Raporti vjetor 2026, Agjencia për Informim dhe Privatësi, <https://ajp.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-performances-se-agjencise-2026-sqarim-raporti-nuk-eshte-aprovuar-akoma-nga-kuvendi-i-republikes-se-kosoves/?wpdmml=11544&refresh=6a3262fa4b9191781687034>

një përpjekje për të kontrolluar mediat online.³² U ngritën shqetësime serioze në lidhje me mungesën e transparencës gjatë procesit të hartimit, si dhe mungesën e konsultimeve kuptimplota.



Delegacioni takoi përfaqësuesit e Gjykatës Themelore të Prishtinës.
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK)

Opinioni ligjor i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian deklaroi se “në përgjithësi, Projektligji është në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audiovizuale. Megjithatë, u ngritën shqetësime në lidhje me qartësinë ligjore, proporcionalitetin e masave dhe devijimet nga legjislacioni i BE-së dhe standardet evropiane, veçanërisht ato të Këshillit të Evropës”.³³ Opinioni deklaroi më tej se “Nuk është e qartë se deri në ç’masë versioni aktual i Projektligjit për KPM-në i është nënshtruar ‘një konsultimi kuptimplotë me akterët kryesorë’, ose deri në ç’masë ka pasur ‘një shpjegim të arsyetimit pas shqyrtimit ose mosshqyrtimit të parashtresave të bëra’”. Parlamenti e injoroi kryesisht opinionin ligjor dhe e miratoi ligjin. Miratimi shkaktoi kritika nga disa ambasada të shteteve anëtare të BE-së.³⁴ Në prill të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi ligjin për shkak të dispozitave që rregullonin punën e anëtarëve të KPM-së, të cilat shkelnin pavarësinë e Komisionit. Gjatë takimit me Kryeministrin Kurti dhe ekipin e tij, ai deklaroi se ligji i ri për KPM-në do të hartohet në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ai gjithashtu deklaroi se ligji do të jetë në përputhje me standardet e BE-së dhe do të hartohet nga ekspertë të BE-së.

Gjersa një zotim i tillë është i mirëpritur, fakti që gjykata më e lartë e vendit u detyrua të rrëzonte një ligj që kërcënonte pavarësinë e KPM-së ishte një zhvillim alarmues që simbolizon presionin në rritje mbi themelet e sistemit mediatik të Kosovës dhe përpjekjen për të ushtruar kontroll politik mbi KPM-në.³⁵

Mungesa e Ligjit të KPM-së ka ndikime të konsiderueshme në funksionimin aktual të Komisionit. Gjatë një takimi me përfaqësuesit e KPM-së, delegacioni u njoftua se për shkak të mungesës së anëtarëve të KPM-së, zyra ekzekutive po drejtonte të gjithë punën. KPM-ja aktualisht ka një staf prej afërsisht 30 punonjësish, megjithëse kanë paraqitur një kërkesë për dyfishimin e këtij numri. Përfaqësuesit sugjeruan që kjo rritje e

³² <https://www.agk-ks.org/lajmet/qeveria-duhet-te-terhiqet-nga-tentativa-per-kontroll-shteteror-te-mediave-online/>

³³ <https://rm.coe.int/opinion-profex-ks/1680afd39e>

³⁴ Ambasadori gjerman reagon pas miratimit të dy ligjeve: Për Kosovën, ‘çdo mundësi e humbur është shumë’ <https://kallxo.com/lajm/ambasadori-gjerman-reagon-pas-miratimit-te-dy-ligjeve-per-kosoven-cdo-mundesi-e-humbur-eshte-shume/>

³⁵ <https://api.webgik-ks.org/Custom/873598ef-0b1a-4fce-aebd-f81a62989dc9.pdf>


stafit ishte e nevojshme për t'iu përgjigjur kompetencës së tyre të re që lidhet me rregullimin e mediave online. Gjersa ankesat e marra nga KPM-ja po marrin përgjigje, ato nuk mund të zbatohen derisa organi të riformohet zyrtarisht. Përfaqësuesit e KPM-së kërkuan që çështja që lidhet me kapacitetin dhe stafin të trajtohet si çështje urgjente (takimi u zhvillua para se Kuvendi të përzgjedhte anëtarët e rinj të bordit).

Rikriminalizimi i mundshëm i shpifjes si vepër penale

Gjatë vitit 2025, të paktën dy anëtarë të lartë të partisë në pushtet Vetëvendosje, Dimal Basha (ish-Kryetar i Parlamentit dhe aktualisht Ministër i Infrastrukturës) dhe Hekuran Murati (Ministër i Finanacave), deklaruan publikisht në dy raste të ndryshme se do të punonin për ta rikriminalizuar shpifjen. Murati tha se do ta bënte mision të tij rregullimin e shpifjes si vepër penale.³⁶

Legjislacioni në lidhje me shpifjen në Kosovë është në fuqi që nga viti 2003, kur hyri në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Fyerja dhe shpifja konsideroheshin vepra penale të dënueshme me gjoba ose me burgim deri në tre muaj.³⁷

Dispozitat e Kodit të Përkohshëm Penal mbi shpifjen ishin në fuqi deri në vitin 2008, kur Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.³⁸ Megjithatë, dispozitat penale për shpifjen nuk u shfuqizuan, kështu që shpifja rregullohej njëkohësisht si nga e drejta civile ashtu edhe nga e drejta penale.³⁹



Gjatë takimit me Kryeministrin, delegacioni pyeti nëse qeveria e tij ka ndërmend të rikriminalizojë shpifjen dhe fyerjen si vepra penale. Kryeministri deklaroi se shpifja dhe fyerja do të mbeten vepra penale civile

³⁶ Hekuran Murati promovon kriminalizimin e shpifjes: "Do të jetë mision i imi." 16 shtator 2025 <https://reporteri.net/lajme/hekuran-murati-promovon-kriminalizimin-e-shpifjes-do-te-jete-mision-i-im/>

³⁷ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/REG/2003/25 2003 nenet 187 dhe 188

³⁸ Ligji Civil Nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes, GZ 24/2008

³⁹ Qëndrim Parimor K.94/2012 2012.

dhe se qeveria e tij nuk planifikon t'i rikriminalizojë këto vepra penale. Delegacioni mirëpret këtë zotim nga Kryeministri.

Sipas të dhënave nga baza e të dhënave e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të kërkuara nëpërmjet kërkesës për qasje në dokumente publike (të drejtës për informim), në vitin 2025, numri i padive të ngritura për shpifje ishte 263, që është pothuajse trefishi i 95 padive në vitin 2020. Në fakt, që nga viti 2020, numri i padive për shpifje është rritur çdo vit. Rikriminalizimi i shpifjes do të përfaqësonte një regres të madh në lirinë e mediave dhe shprehjen e lirë, pasi krijon një efekt frenues tek gazetarët dhe mund të abuzohet lehtësisht nga autoritetet ose ata që synojnë ta heshtin raportimin në interes publik. Rregullimi i shpifjes dhe fyerjes nëpërmjet ligjit civil u lejon individëve të kërkojnë kompensim financiar nëpërmjet dëmeve dhe të kërkojnë korrigjime, gjë që është e mjaftueshme për të mbrojtur reputacionin.

Transpozimi i standardeve të BE-së dhe Këshillit të Evropës mbi lirinë e mediave

Gjatë misionit, delegacioni ngriti me kryeministrin dhe akterë të tjerë nevojën për të transpozuar disa direktiva dhe rregullore evropiane që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e mediave, siç janë Direktiva Anti-SLAPP dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës Kundër SLAPP-ve, Akti Evropian për Lirinë e Mediave dhe Akti i Shërbimeve Digjitale.

Në një përgjigje me shkrim, zyra e Kryeministrit deklaroi se “Kosova tashmë ka ndërmarrë hapa drejt përafrimit të legjislacionit të saj për mediat me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë futjen e elementeve të Direktivës për Shërbimet e Mediave Audiovizuale në Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave. Ky proces i përafrimit do të vazhdojë me ndryshimet e ardhshme dhe Ligjin e ri për Komisionin e Pavarur të Mediave, ku Kosova synon të harmonizojë më tej kornizën e saj ligjore me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së në fushën e mediave dhe shoqërisë së informacionit.”

Gazetarët në rezidencë (gazetarët ukrainas)

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Mediave (ECPMF), Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ) dhe Unioni Kombëtar i Gazetarëve të Ukrainës (NUJU), në bashkëpunim me Qeveritë e Kosovës dhe Gjermanisë, po zbatojnë programin “Gazetarët në Rezidencë”, përmes të cilit gazetarë nga Ukraina dhe Afganistani janë strehuar në Kosovë që nga prilli i vitit 2022. Projekti financohet nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Gjermanisë dhe mbështetet nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Deri më tani, 25 gazetarë nga Ukraina dhe Afganistani kanë përfituar nga programi, 10 prej të cilëve vazhdojnë të jetojnë dhe punojnë në Kosovë. Programi “Gazetarët në Rezidencë”, i financuar nga qeveria e Kosovës dhe ajo e Gjermanisë, është një iniciativë unike në nivel global dhe e vlerësuar nga NUJU.⁴⁰

40 Kosova vazhdon të mbështesë Ukrainën, në veçanti, ekziston një program për mbrojtjen e gazetarëve. <https://nuju.org.ua/kosovo-continues-to-support-ukraine-in-particular-a-program-to-protect-journalists-is-in-place/>

Rekomandimet

Rekomandime të përgjithshme

1. Qeveria në ardhje duhet ta përmirësojë situatën e lirisë së mediave si çështje prioritare duke e integruar atë zyrtarisht në programin vjetor qeveritar, agjendën legjislative dhe politikat e tjera që ndikojnë në lirinë e mediave. Në veçanti, qeveria duhet ta emërojë një Ministri ose Zyrën e Kryeministrit që të jetë përgjegjëse për propozimin e legjislacionit në lidhje me lirinë e mediave dhe përafrimin e politikave në lidhje me lirinë e mediave me standardet evropiane. Aktualisht, asnjë nga ministritë nuk e ka median në portofolion e saj, gjë që e bën të vështirë të kesh një autoritet përgjegjës që punon për përmirësimin e politikave në lidhje me lirinë e mediave.

2. Si anëtare e Koalicionit për Lirinë e Medias (KLM), Kosova duhet të zbatojë plotësisht angazhimet që rrjedhin nga miratimi i Premtimit Global për Lirinë e Medias dhe të angazhohet me Panelin e Nivelit të Lartë të Ekspertëve për Lirinë e Medias gjatë hartimit të legjislacionit mbi lirinë e medias, përfshirë ligjin për KPM-në. Gjithashtu duhet të angazhohet në mënyrë aktive në Koalicion duke ofruar përditësime të rregullta mbi zhvillimet dhe iniciativat përkatëse.

Siguria e gazetarëve

3. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e plotë të Rekomandimit CM/Rec(2016)4 të Këshillit të Evropës të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi mbrojtjen e gazetarëve dhe sigurinë e gazetarëve dhe akterëve të tjerë të mediave dhe Rekomandimit të Komisionit të datës 16.9.2021 mbi ofrimin e mbrojtjes, sigurisë dhe fuqizimit të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të mediave në Bashkimin Evropian.

4. Kryeministri në detyrë dhe kryetari i partisë Vetëvendosje duhet të përmbahet nga përdorimi, miratimi ose nxitja e gjuhës ose retorikës kundër mediave. Kryeministri në detyrë duhet t'u dërgojë më tej një mesazh të qartë anëtarëve dhe mbështetësve të tij se abuzimi verbal kundër gazetarëve, mediave dhe aktivistëve të shoqërisë civile është akt i papranueshëm. Delegacioni beson se një qasje e tillë do të dërgonte një sinjal të qartë se retorika negative kundër gazetarëve nuk do të përdoret më si mjet politik kundër kritikave.

5. Udhëheqësit politikë duhet ta vlerësojnë sigurinë e gazetarëve si prioritet për të siguruar lirinë e mediave në Kosovë dhe për të garantuar kushte të favorshme për gazetarët dhe profesionistët e mediave që ata të kryejnë punën e tyre në mënyrë të sigurt dhe të lirë. Ata nuk duhet të përdorin asnjë retorikë armiqësore dhe delegjitimuese që dëmton besueshmërinë dhe reputacionin e profesionit, dhe duhet të dënojnë hapur çdo formë denigrimi, ngacmimi ose abuzimi ndaj gazetarëve, me vëmendje të veçantë ndaj dimensionit gjinor të sulmeve që shënjestrojnë gratë gazetare.

6. Qeveria duhet të propozojë, dhe parlamenti duhet të miratojë, ndryshime në Kodin Penal për të forcuar mbrojtjen e gazetarëve, duke përfshirë njohjen e sulmeve kundër gazetarëve në lidhje me punën e tyre si rrethana rënduese në procedurat penale.

7. Qeveria e ardhshme duhet t'i bashkohet fushatës "Journalists Matter" të Këshillit të Evropës, të miratojë një Strategji Kombëtare për Lirinë e Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve dhe të emërojë një pikë kontakti (ekip) për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve.

Transmetuesi publik

8. Qeveria e ardhshme e Kosovës duhet të përfshijë në agjendën e saj legislative ndryshimin e Ligjit për Transmetuesin Publik dhe të sigurohet që ai të jetë në përputhje me standardet e BE-së dhe të Këshillit të Evropës.

9. RTK duhet të veprojë lirshëm dhe pa ndërhyrje politike. Gazetarët duhet të jenë në gjendje të raportojnë për çështje me interes publik pa ndërhyrje dhe duhet të jenë në gjendje t'u bëjnë pyetje lirisht përfaqësuesve të qeverisë pa frikën e përballjes me pasojat.

10. Qeveria e ardhshme duhet të sigurojë që Radiotelevizioni i Kosovës të marrë financimin e plotë të përcaktuar me ligj dhe të zhvillojë një mekanizëm financimi të qëndrueshëm dhe politikisht të pavarur në përputhje me Rekomandimin 1878 (2009) të Këshillit të Evropës dhe Nenin 5 të Aktit Evropian për Lirinë e Mediave (EMFA).

11. Qeveria e ardhshme duhet të gjejë një zgjidhje për çështjen e pronës së RTK-së, në mënyrë që ajo të mund të veprojë në ambiente të përshtatshme. Çështja e pazgjidhur e pronës përbën një pengesë të vërtetë për punën e gazetarëve, pasi ata aktualisht operojnë në kushte të vështira.

12. Kuvendi i Kosovës (komisioni për media) duhet të monitorojë nga afër punën e anëtarëve të bordit të RTK-së për të siguruar që RTK qeveriset në përputhje me ligjin e saj dhe standardet më të mira evropiane.

Komisioni i Pavarur i Mediave

13. Qeveria e ardhshme duhet të hartojë një ligj të ri për KPM-në në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në konsultim kuptimplotë me shoqërinë civile, akterët mediatikë dhe partnerët ndërkombëtarë.

14. Anëtarët e KPM-së duhet të veprojnë lirshëm, në mënyrë të pavarur dhe profesionale dhe duhet të refuzojnë çdo ndërhyrje politike ose të ndonjë lloji tjetër gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

15. Kuvendi i Kosovës duhet të monitorojë nga afër punën e anëtarëve të KPM-së, veçanërisht kur dihet procesi i emërimit të tyre përmes një procedure të kompromentuar, për të siguruar që sektori i mediave rregullohet në përputhje me ligjin e KPM-së dhe standardet më të mira evropiane.

Legjislacioni dhe transpozimi i standardeve të BE-së dhe KiE-së

16. Delegacioni rekomandon fuqishëm ruajtjen e statusit të dekriminalizuar të shpifjes dhe thërret për përmbajtje nga çdo hap legjislativ drejt rikriminalizimit të saj, duke mirëpritur njëkohësisht angazhimin e shprehur nga Kryeministri Albin Kurti për të mos ndjekur ndryshime të tilla.

17. Qeveria duhet të ndryshojë ligjet si në vijim: Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, me qëllim forcimin e pavarësisë së mediave dhe mbrojtjes për gazetarët.

18. Qeveria duhet ta harmonizojë legjislacionin e saj me direktivat e mëposhtme: Aktin Evropian për Lirinë e Mediave, Aktin e Shërbimeve Digjitale, Direktivën e BE-së Kundër SLAPP-ve dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës mbi SLAPP-të, duke përfshirë sigurimin e mbrojtjes kundër rasteve vendore të SLAPP-ve.

Sistemi gjyqësor

19. Delegacioni rekomandon fuqishëm që Akademia e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës të vazhdojnë ndërtimin e kapaciteteve për gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe zyrtarët e policisë mbi lirinë e mediave, sigurinë e gazetarëve, shpifjen, SLAPP-et dhe tema të tjera të ndërlidhura.

20. Projekti i Këshillit të Evropës dhe BE-së "PROFLEX", i cili ka trajnuar qindra profesionistë ligjorë në dekadën e fundit në Kosovë, ofron një shembull të ndërtimit të kapaciteteve për profesionistët ligjorë, të cilët duhet të vazhdojnë të sigurojnë që sistemi gjyqësor t'i trajtojë rastet e tilla në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe standardet e tjera evropiane. Delegacioni i kërkon Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë të vazhdojnë ndërtimin e kapaciteteve mbi standardet e lirisë së mediave për gjyqtarët dhe profesionistët ligjorë dhe të mediave.

